



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KLOS  
KRYETARI

Nr. 904 Prot.

Klos, më 20.03 2024

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_ datë \_\_. \_\_. 2024

**PËR**

**MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUSIN E SHOQËRISË SË  
BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR "OPERATORI I RRUGËVE RURALE DHE  
TURISTIKE" (ORRT)**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak" pika "k", Ligji nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, Vendimin nr. 255 datë 31.01.2024 të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në të cilin është vendosur miratimi i themelimit të operatorit për hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe turistike (rrugë të bardha) në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke ushtruar fillimin e veprimtarisë me zbatimin e projektit pilot në Qarkun Dibër, ku janë të përfshira të katër Bashkitë e Qarkut Dibër me përqindje kapitali secila me 10%, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përqindje kapitali 52%, Agjencia Kombëtare Mbështetëse AEM me përqindje kapitali 2%, Agjencia e Menexhimit të Investimeve me përqindje kapitali 2%, Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion HUBEX me përqindje kapitali 2%, Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje AGREGATORI me përqindje kapitali 2%, i kërkojmë Këshillit Bashkiak të

**VENDOSË:**

1. Miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statusin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" (ORRT), i krijuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ku pjesë e shoqërisë është dhe Bashkia Klos.
2. Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.

KRYETARI BASHKISË  
Valbona Kola





FONDI SHQIPTAR  
I ZHVILLIMIT

Ma. 820 prot  
dtk. 08.03.2024

Nr. 327 prot.

Tiranë, më 08.03.2024

Lënda: Dërgohen dokumentet për themelimin e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike (ORRT)

Drejtuar: Z. Agron Malaj, Kryetar, Bashkia MAT  
Adresa: Sheshi "Kastriotët", nr. 1, Burrel

Znj. Festime Mjeshtri, Kryetar, Bashkia BULQIZË  
Adresa: Lagjia "Minatori", Bulqizë

Z. Rahim Spahiu, Kryetar, Bashkia DIBËR  
Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

Znj. Valbona Kola, Kryetar, Bashkia KLOS ✓  
Adresa: Rr. "Jaho Hoxha", Nd. 2, H.2, Klos

Të nderuar Kryetarë,

Në vijim të komunikimeve të përbashkëta për krijimin e shoqërisë "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" (ORRT), ju informojmë se, me vendimin nr. 255, datë 31.01.2024; të Këshillit Drejtues të FSHZH, është vendosur miratimi i themelimit të operatorit për hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe turistike (rrugë të bardha) në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke filluar ushtrimin e veprimtarisë me zbatimin e projektit pilot në qarkun Dibër.

Sa më sipër, janë draftuar aktet për themelimin dhe regjistrimin e operatorit në formën e një shoqërie bashkëpunimi bujqësor, të cilat duhet të kalojnë për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillave tuaj Bashkiakë.

Bashkëlidhur do të gjeni Aktin e Themelimit si dhe Statutin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike" ("ORRT").

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

Dritan AGOLLI

DREJTOR EKZEKUTIV



**SHOQËRIA E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR**  
**“OPERATORI I RRUGËVE RURALE DHE TURISTIKE”**  
**(ORRT)**

**Data e Themelimit:** \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**Data e Statutit:** \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**STATUTI**

# STATUTI

---

## KAPITULLI I

### EMRI, FORMA, SELIA DHE KOHËZGJATJA

#### 1. EMRI I SHOQËRISË

1.1 Emri i Shoqërisë është “Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike”-“ORRT” (këtu e në vijim “Shoqëria”), i cili paraprihet në mënyrë të pandashme nga fjalët “Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor”, të cilat përfaqësojnë formën ligjore të saj.

1.2 Anëtarët e shoqërisë “Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike”-“ORRT” (këtu e në vijim “Anëtarët”) janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të nënshkruara të kapitalit të shoqërisë të përfaqësuar në kuota (këtu e në vijim “Kuota”).

1.3 Në të gjitha shkresat, publikimet dhe dokumentet e shoqërisë, emërtimi i saj paraprihet nga fjalët “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor”, pas të cilave shënohet emërtimi i shoqërisë dhe numri i regjistrimit të saj. Gjithashtu, në dokumentet, faturat, reklamimet dhe botimet e Shoqërisë, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, shënohen edhe: (i) adresa e regjistruar; si dhe (ii) pasqyrimi i faktit nëse shoqëria është në procedura likuidimi, në qoftë se ky rast paraqitet.

1.4 Në asnjë rast një shoqëri tjetër nuk mund të përdorë emërtimin e përcaktuar në nenin 1.1 të këtij Statuti.

#### 2. FORMA LIGJORE

2.1 Shoqëria është një subjekt i së drejtës shqiptare dhe ka formën ligjore të një shoqërie bashkëpunimi bujqësor, në përputhje me ligjin nr. 38/2012, datë 5.4.2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor” (këtu e në vijim “Ligji i shoqërive të bashkëpunimit bujqësor”).

#### 3. SELIA

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. "Muhamet Gjollësja", nd. 70/1, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.

3.3 Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



## **4. KOHËZGJATJA**

4.1 Shoqëria ushtron veprimtari për një kohëzgjatje të pacaktuar.

### **KAPITULLI II**

## **QËLLIMI, OBJEKTI, MISIONI, FUNKSIONET, TË DREJTA DHE DETYRIME TË SHOQËRISË**

### **5. QËLLIMI, MISIONI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

#### **5.1 Qëllimi i shoqërisë**

Qëllimi i aktivitetit të shoqërisë është për rritjen e mirëqënies së banorëve dhe zhvillimin e zonave rurale dhe atyre me potencial zhvillimi, duke synuar:

- a) Përmirësimin e aksesit dhe konektivitetit midis këtyre zonave dhe akseve kombëtare apo qendrave urbane;
- b) Zgjimim e potencialeve për zhvillim dhe mbështetjen e iniciativave të reja sipërmarrëse në këto zona;
- c) Formësimin e sinergjisë mes aktorëve lokalë, qofshin ata publik, qendror apo vendor, sipërmarrje private, organizma jofitimprurës, apo komunitete lokale;
- d) Ngritjen e formave të reja dhe inovatore të qeverisjes sipërmarrëse, duke ngritur modele bashkëqeverisjeje dhe partneritete rajonale mes njësisive të vetëqeverisjes vendore;
- e) Ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve teknike, ekonomike, njerëzore, të njësisive të vetëqeverisjes vendore apo ndërmarrjeve/njësive në varësi të tyre.

#### **5.2 Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është identifikimi, inventarizimi, vlerësimi, projektimi, ndërtimi, administrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale, turistike dhe bujqësore, etj, të cilat nuk përfshihen në inventarin e rrugëve kombëtare.

#### **5.3 Misioni i shoqërisë**

Manaxhimi i objektit të veprimtarisë duke krijuar sinergjinë e nevojshme mes aktorëve për të realizuar objektin e veprimtarisë në kohën më të shpejtë të mundshme, në koston më të ulët të mundshme, në cilësinë më të mirë të mundshme, duke respektuar standardet përkatëse.

#### **5.4 Funkcionet e shoqërisë**

Funksionet kryesore të shoqërisë, janë:

- a) Hartimi dhe implementimi i një plani operacional të biznesit/aktivitetit 3-vjeçar me detajimin vjetor, që do përmbajë, Inventarizimin, Vlerësimin dhe vendosjen e objektivave dhe prioriteteve të ndërhyrjeve, duke përcaktuar, rregullat përkatëse, burimet dhe startegjinë e sigurimit të tyre, strukturat përgjegjëse dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre si dhe proceset kryesore të punës që do ndiqen. Planin operacional të biznesit, miratohet nga Asambleja dhe përditësohet në mënyrë periodike çdo vit të ri buxhetor.
- b) Sigurimi i paketës teknike të ndërhyrjeve, përfshirë projektet e zbatimit, analizat e kostove dhe të burimeve dhe materialeve të nevojshme, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe kërkesat e nevojshme për respektimin e standardeve të përcaktuara.
- c) Organizimi dhe koordinimi i punës për garantimin e burimeve për realizimin e ndërhyrjeve, përfshirë, makineritë e nevojshme, materialet, burimet njerëzore, apo shërbimet e ndryshme të nevojshme për realizimin e ndërhyrjeve të kërkuara.
- d) Monitorimi dhe kontrolli i realizimit të ndërhyrjeve nga ndërmarrjet bashkiake apo të tretët, në përputhje me projektin, analizat e kostove, grafikun e punimeve, specifikimeve teknike dhe normave të kërkuara në respekt të standardeve të përcaktuara.
- e) Certifikimi i punimeve në raport me objektivat dhe planin e ndërhyrjeve.
- f) Çdo aktivitet tjetër që lidhet dhe i shërben ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- g) Në funksion të aktiviteteve, shoqëria ka të drejtë: të përcaktojë një tarifë për aktivitetin e saj, e cila do të përcaktohet në dokumentin e planit të biznesit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

### **5.5 Të drejtat e shoqërisë:**

- a) Shoqëria mund të realizojë çdo lloj aktiviteti, operacion financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi; financimin ose bashkëfinancimin e projekteve nëpërmjet instrumenteve ekonomike për realizimin e objektivave të përcaktuara në statut.
- b) Shoqëria mund të hyjë në marrëveshje partneriteti për plotësimin e objektivave të saj, vetë apo në bashkëpunim me aktorë publikë dhe/ose privatë, vendas ose të huaj, duke realizuar çdo aktivitet të mundshëm brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni dhe statuti.

- c) Kryen çdo veprim tjetër që favorizon dhe lehtëson përmirësimin ekonomik, teknik, të zonave rurale në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- d) Në përputhje me kuadrin ligjor të aplikueshëm, në mënyrë që të arrihet qëllimi i lartpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:
  - i. të mundësojë trajnime profesionale për anëtarët e saj apo palët e treta;
  - ii. të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore, që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
  - iii. të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;
  - iv. të zotërojë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri;
  - v. të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të anëtarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit në fuqi.
- e) Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.
- f) Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë ushtrimin e aktivitetit.
- g) Shoqëria kryen veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar më sipër, përveçse me anëtarët e saj edhe me persona fizikë ose juridikë, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 (*dyzet*) për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtari të saj, në përputhje me dispozitat e ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.

## 6. NDRYSHIME

6.1 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

## KAPITULLI III

### ANËTARËT

## 7. ANËTARËT E SHOQËRISË

### 7.1 Anëtarët themelues

Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike” - “ORRT”, ka si anëtarë të saj themelues:

Nr.	Anëtar:
1	<b>Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)</b>
2	<b>Bashkia MAT</b>
3	<b>Bashkia KLOS</b>
4	<b>Bashkia BULQIZË</b>
5	<b>Bashkia DIBËR</b>
6	“Agjencia Ekonomike Mbështetëse” <b>AEM sh.p.k.</b>
7	“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve” <b>AMI sh.p.k.</b>
8	“ <b>HUBEX-Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion</b> ”
9	“ <b>AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje</b> ”

## 7.2 Kushtet për anëtarët:

- a) Anëtarë të shoqërisë janë personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e zhvillimit rajonal, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv në nivel rajonal e vendor si dhe personat juridikë të krijuar prej tyre; njësitë e vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë; institucionet e tjera publike dhe persona juridikë të tjerë, të cilët përmbushin nevojat dhe interesat e tyre nëpërmjet shërbimeve, mallrave apo produkteve të ofruara nga shoqëria. Numri i anëtarëve është i pakufizuar, por në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 7.
- b) Me qëllim përmbushjen e objektit të shoqërisë, anëtarët janë të detyruar të marrin pjesë dhe të angazhohen për realizimin e politikave ekonomike dhe sociale të shoqërisë.
- c) Çdo person juridik anëtar duhet të kenë fituar personalitetin juridik dhe ndaj tyre nuk duhet të ketë filluar asnjë procedurë likuidimi apo falimentimi.
- d) Nuk mund të jenë anëtarë personat juridikë që kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë. Gjithashtu, nuk mund të jenë anëtarë personat juridikë që bashkëpunojnë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë dhe në dëm të interesave të saj, përveç rasteve kur asambleja e përgjithshme vendos që është në interesin më të lartë të shoqërisë që ata të jenë anëtarë.

## 8. ROLI I ANËTARËVE

Shoqëria ORRT krijohet në bashkëpunim me aktorë në nivel qendror dhe lokal, institucional dhe komunitar, dhe do të realizojë mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve rurale, bujqësore dhe turistike në vend.



## 8.1 FSHZH dhe entitetet e saj

FSHZH dhe personat juridikë të themeluar prej saj (AEM, AMI, HUBEX, AGREGATORI), në kuadër të programit operacional, do të kontribuojnë duke mbështetur veprimtarinë e shoqërisë ORRT, përmes:

- a) programeve dhe ndërhyrjeve konkrete, lëndë të para, makineritë e ndërtimit, etj.;
- b) konsulencë, ekspertiza, analiza, të dhëna teknologjike, etj.;
- c) ngritje kapacitetesh dhe logjistike;
- d) platforma dhe shërbime teknologjike;
- e) bërja bashkë e aktorëve, mbledhja e kontributeve nga palët e treta, etj.;
- f) promovimi dhe marketingu i produktit konkret.

## 8.2 Bashkitë

Bashkitë, do të jenë bashkë-kontribues përmes:

- a) angazhimit të ndërmarrjeve publike që ato menaxhojnë apo burimeve të tjera që disponojnë;
- b) kontributit në natyrë me mjete, makineri ndërtimi, lëndë të para nga burime natyrore lokale, mbështetjes financiare etj.;
- c) ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale, bujqësore dhe turistike;
- d) si dhe marrin përsipër të garantojnë vendndodhjen, ruajtjen, dhe sigurinë e mjeteve/makinerive.

## 9. PRANIMI I ANËTARËVE TË RINJ

9.1 Kërkesa për pranimin e anëtarit të ri në Shoqëri bëhet me shkrim, i drejtohet administratorit dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

- a), të dhëna mbi emërtimin e personit juridik, datën e regjistrimit, selinë dhe objektin e veprimtarisë;
- b) sasinë e kuotave që kandidati për anëtar do të nënshkruajë;
- c) deklaratën e përmbyshjes së kriterëve për të qenë anëtar, sipas përmbajtjes së mëposhtme:

*“Kandidati për anëtar, me anë të nënshkrimit të kërkesës për pranimin si anëtar, deklaroj se përmbysh kriteret për të qenë anëtar i shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor “Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike”-“ORRT” dhe pranoj që të zbatoj aktin e themelimit, statutin dhe vendimet e organeve*

*drejtuese të shoqërisë si dhe të zbatoj standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga anëtarësia në shoqëri. Kandidati për anëtar, gjithashtu deklaroi që në dijeninë e tij nuk ekziston asnjë shkak që kufizon anëtarësinë e tij në shoqëri”.*

- d) kërkesa duhet të jetë nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik;
- e) kërkesa duhet të shoqërohet me vendimin e organit përkatës që ka të drejtë të kërkojë pranimin si anëtar. Vendimi duhet të përmbajë edhe deklaratën e përmbushjes së kriterëve për të qenë anëtar, sipas formulimit të mësipërm, si dhe sasinë e kuotave që do të nënshkruhen.

9.2 Çdo kandidat për anëtar, së bashku me kërkesën për pranimin si anëtar, duhet të parapaguajë edhe vlerën e kuotave që do të nënshkruajë.

9.3 Administratori, pasi verifikon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe këtë Statut, ia kalon kërkesën asamblesë së përgjithshme e cila vendos në mbledhjen e saj më të parë. Në rast se administratori çmon se kërkesa nuk i përmbush kriteret e përcaktuara si më sipër, ia kthen atë kërkuesit me udhëzimet përkatëse për përmbushjen e kriterëve. Kandidati për anëtar mund të ankohej ndaj vendimit të administratorit në mbledhjen më të parë të asamblesë së përgjithshme.

9.4 Anëtari i ri konsiderohet i pranuar nga momenti kur merr njoftimin për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme që miraton pranimin e tij. Pas marrjes së vendimit të pranimit nga Asambleja e Përgjithshme dhe pas njoftimit të anëtarit të ri, Administratori kryen regjistrimit përkatës në regjistrin e anëtarëve që mban shoqëria si dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

9.5 Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos të refuzojë kërkesën për pranimin e anëtarit të ri, Administratori i kthen menjëherë kërkuesit shumën e parapaguar për vlerën e kuotave sipas nenit 9.2.

9.6 Shoqëria mban në selinë e saj një regjistër të anëtarëve, i cili është publik dhe i konsultueshëm dhe që përmban të gjitha të dhënat identifikuese të anëtarëve, adresat, si dhe kapitalin e nënshkruar e të shlyer prej tyre.

## **10. TË DREJTAT E ANËTARËVE**

10.1 Anëtarët kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) të propozojnë ndryshimin e administratorit të shoqërisë;
- b) të propozojnë ndryshime apo përmirësime të statutit;



- c) të zgjidhen dhe të zgjedhin organet drejtuese, si dhe të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimeve të shoqërisë apo mbulimin e humbjeve sipas statutit;
- d) të kërkojnë dhe disponojnë kopje të statutit, të rregullores së brendshme apo të vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë;
- e) të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për gjendjen financiare dhe ekonomike të tyre brenda shoqërisë;
- f) të informohen, sa herë që depozitojnë kërkesë me shkrim, lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, kryesisht, për:
  - i. llogaritë vjetore financiare;
  - ii. raportin e veprimtarisë së shoqërisë;
  - iii. mënyrën dhe procedurat e ndarjes së fitimit apo mbulimit të humbjeve;
  - iv. raportet e ekspertëve kontabël.
- g) informohen rregullisht për mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, duke përfshirë në informacion pikat e rendit të ditës, dokumentacionin e përgatitur për mbledhje, si dhe të dhëna të tjera, të cilat lidhen me vendimmarrjen për çështje të caktuara, të cilat mund të prekin interesat e tyre.

10.2 Administratori është i detyruar të informojë me shkrim anëtarin për çështjet e trajtuara në kërkesën e tij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj.

10.3 Anëtari kërkues ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e dhënies së informacionit, duke iu drejtuar gjykatës brenda 30 ditëve nga njoftimi për refuzim, ose brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, në rast se kërkesa e tij lihet pa përgjigje.

## 11. DETYRIMET E ANËTARËVE

11.1 Anëtarët janë të detyruar të përmbushin detyrimet e parashikuara nga ligji për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor si dhe ky Statut dhe veçanërisht:

- a) të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
- b) të zbatojnë marrëveshjet e miratuara nga organet e shoqërisë;
- c) të zbatojnë politikat dhe rregulloret operacionale që do të miratojë shoqëria;
- d) të zbatojnë dhe respektojnë vendimet e organeve drejtuese të Shoqërisë;
- e) të marrin pjesë në veprimtari që përbëjnë objektin e shoqërisë, sipas përcaktimit të Kapitullit II të këtij statuti, përveç rasteve kur asambleja e përgjithshme, për një shkak të justifikueshëm, e përjashton nga ky detyrim në masën që i takon dhe sipas rrethanave;

- f) të ruajnë sekretin për ato çështje dhe të dhëna të shoqërisë, përhapja e të cilave mund të dëmtojë interesat e ligjshëm të saj;
- g) të mos kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë dhe objektit të saj dhe të mos bashkëpunojë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë dhe në dëm të interesave të saj, me përjashtim të rasteve kur autorizohen formalisht nga asambleja e përgjithshme;
- h) të marrin pjesë në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit;
- i) të kryejnë derdhjen e kontributeve të tyre në kapitalin e shoqërisë në mënyrën e parashikuar;
- j) të zbatojnë/përmbushin dhe respektojnë çdo detyrim që rrjedh nga ligji, statuti dhe rregulloret e brendshme;
- k) të njoftojnë menjëherë çdo ndryshim të adresës apo çdo fillim procedure likuidimi ose falimentimi.

## 12. LARGIMI I ANËTARIT

12.1 Anëtari mund të largohet nga shoqëria nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

- a) vullnetarisht, me anë të dorëheqjes;
- b) i detyruar, me anë të përjashtimit në rastet e parashikuara në ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe sipas procedurave të nenit 14 të statutit;
- c) kur, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 30, transferon pjesën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë person juridik, i cili ka marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme për të qenë anëtar;
- d) në rast likuidimi;
- e) në rast falimentimi;
- f) në çdo rast tjetër, sipas përcaktimeve që mund të kryhen nga Asambleja e Përgjithshme.

12.2 Administratori shprehet me vendim të motivuar për largimin e anëtarit, për secilin prej rasteve të parashikuara në nenin 12.1, dhe vendimin e marrë ia përcjell për miratim asamblesë së përgjithshme.

12.3 Administratori është i detyruar të shënojë në regjistrin e anëtarëve, që mbahet nga shoqëria, si dhe të regjistrojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit largimin e anëtarit dhe çdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nënshkruar apo mënyrën e ndarjes së tij, si rrjedhojë e largimit të anëtarit.

### **13. LARGIMI VULLNETAR I ANËTARIT**

13.1 Largimi vullnetari i anëtarit lejohet, përveç shkaqeve të parashikuara nga ligji, edhe për shkaqet e mëposhtme:

- a) për shkak të humbjes së kriterëve të pranimit;
- b) për shkak të pamundësisë së anëtarit që të marrë pjesë në përmbushjen e objektit të shoqërisë.

13.2 Largimi vullnetar i anëtarit nuk mund të jetë i pjesshëm. Anëtari është i detyruar të njoftojë me shkrim shoqërinë 60 ditë përpara datës së largimit.

13.3 Administratori verifikon nëse ekzistojnë kushtet për largimin vullnetar të anëtarit dhe në rast se çmon që nuk dëmtohen interesat e shoqërisë, shprehet me vendim të motivuar dhe ia dërgon vendimin Asamblesë së Përgjithshme për miratim. Anëtari konsiderohet i larguar nga shoqëria pas miratimit nga asambleja e përgjithshme.

13.4 Në rast se administratori çmon që nuk ekzistojnë kushtet për largimin vullnetar të anëtarit apo largimi i anëtarit do të sillte dëme të pariparueshme për shoqërinë, vendos për mospranimin e kërkesës për largim vullnetar të anëtarit.

13.5 Vendimi i administratorit për pranimin e kërkesës apo për refuzimin e saj duhet të merret brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

13.6 Anëtari kërkues ka të drejtë të kundërshtojë vendimin e administratorit për mospranimin e kërkesës, duke iu drejtuar gjykatës brenda 30 ditëve nga njoftimi për refuzimin e kërkesës.

### **14. PËRJASHTIMI I ANËTARIT**

14.1 Anëtari mund të përjashtohet nga shoqëria me vendim të asamblesë së përgjithshme, në rastin kur:

- a) ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të tij ose ka vepruar në kundërshtim me interesat e shoqërisë;
- b) nuk plotëson kriteret për të qenë anëtar, sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit buqësor dhe këtij statuti;
- c) ka shkelur detyrimet e tij, të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “d”, “g”, “i”, “j” të nenit 11.1, të këtij statuti;
- d) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve ndërmjet anëtarit dhe shoqërisë.

14.2 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të përcaktojë si shkaqe të arsyeshme, çdo veprim apo mosveprim, si dhe çdo gjendje të Anëtarit, sipas rastit, me qëllim mbrojtjen e interesave të shoqërisë.

14.3 Vendimi për përjashtimin e anëtarit merret nga Asambleja e Përgjithshme pas propozimit të administratorit ose anëtarëve të tjerë që përfaqësojnë jo më pak se 10% të kapitalit të regjistruar.

14.4 Vendimi i largimit i njoftohet anëtarit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së komunikimit me shkrim.

14.5 Anëtari ka të drejtë të kundërshtojë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për përjashtimin e tij, duke iu drejtuar gjykatës brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për përjashtimin e tij.

14.6 Shoqëria ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga Anëtari i përjashtuar.

## **15. TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA LARGIMI VULLNETAR APO PËRJASHTIMI**

15.1 Anëtarët e larguar vullnetarisht apo të përjashtuar nga shoqëria, kanë të drejtë të rimburohen për kontributet e derdhura në kapitalin e shoqërisë, me përjashtim të rastit kur kanë detyrime të pashlyera kundrejt Shoqërisë apo kur i kanë shkaktuar një dëm Shoqërisë.

15.2 Rimbursimi do të bëhet pa prekur pjesën e kapitalit minimal prej 100,000 lekësh të përcaktuar nga ligji.

15.3 Rimbursimi duhet t'i bëhet anëtarit të larguar brenda 180 ditëve nga data e miratimit të bilancit nga Asambleja e Përgjithshme dhe shoqëria ka të drejtë të mbajë çdo shumë që anëtari mund t'i detyrohet shoqërisë për shkak të shërbimeve të përfituara ose për shkak të dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit.

15.4 Kjo e drejtë parashkruhet nëse rimbursimi nuk kryhet brenda 5 vjetësh nga data e largimit të anëtarit.

15.5 Vlera e kuotave për të cilat plotësohet afati i parashkrimit, destinohen në fondin e rezervës së detyrueshme.

15.6 Anëtarët e larguar vullnetarisht si dhe ata të përjashtuar, mund të ripranohen në Shoqëri. Në kërkesën për ripranim duhet të deklarohet shprehimisht kapërcimi i shkaqeve që çuan në largimin vullnetar apo përjashtimin e anëtarit.



## KAPITULLI IV ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

### 16. KOMPETENCAT

16.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqërisë.\*

16.2 Asambleja e përgjithshme ka këto kompetenca:

- a) vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;
- b) analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që çmohen të rëndësishme;
- c) emëron dhe shkarkon administratorin, ekspertin kontabël dhe likuiduesin, si dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre;
- d) miraton zvogëlimin apo zmadhimin e kapitalit;
- e) miraton ndryshime të statutit;
- f) vendos për shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe këtij Statuti;
- g) vendos shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë;
- h) vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
- i) vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre;
- j) miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël dhe të likuiduesve;
- k) miraton pranimin e anëtarëve të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe largimin apo përjashtimin e tyre;
- l) përfaqësimin në gjykatë të shoqërisë dhe në procedura të tjera, kundër Administratorëve apo anëtarëve;
- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- n) çdo detyrë tjetër që çmohet e rëndësishme për mbrojtjen e interesave dhe nevojave të shoqërisë apo anëtarëve të saj.

16.3 Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme, i marrë në përputhje me dispozitat e ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe këtij Statuti, është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

## **17. KRYETARI DHE SEKRETARI I ASAMBLESË**

17.1 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, i cili zgjidhet nga Asambleja ndërmjet përfaqësuesve të anëtarëve të saj, për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

17.2 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme kontrollon rregullshmërinë e thirrjes së mbledhjes, kontrollon dhe pranon legjitimitetin e anëtarëve ose përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në mbledhje, kryeson mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me rendin e ditës, si dhe certifikon rezultatet e votimit.

17.3 Asambleja se Përgjithshme cakton një sekretar të saj, i cili ka për detyrë të mbajë procesverbalet e mbledhjes, nën kujdesin e Kryetarit.

## **18. THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

18.1 Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara me ligj, në këtë statut apo sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, si dhe për çdo çështje e cila nuk i është deleguar Administratorit. Asambleja e përgjithshme thirret të paktën një herë në vit dhe brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

18.2 Asambleja e Përgjithshme si rregull mblidhet në selinë e Shoqërisë.

18.3 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori ose nga çdonjëri prej Anëtarëve që përfaqëson të paktën 10% të kapitalit të shoqërisë.

18.4 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojn ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

18.5 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në çdo mënyrë tjetër, aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e të gjitha asetëve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

18.6 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një anëtar pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% e asetëve të Shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



18.7 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, me postë të porositur ose elektronike, përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, duhet të përmbajë: (i)emërtimin e shoqërisë dhe selinë e regjistruar; (ii)vendin, datën dhe orën e mbledhjes; (iii)rendin e ditës.

## **19. E DREJTA E VOTËS**

19.1 E drejta e votës është sipas përqindjes së zotëruar. E drejta e votës gëzohet nga ata anëtarë të cilët janë regjistruar në Regjistrin e Anëtarëve të Shoqërisë dhe respektivisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

19.2 E drejta e votës ushtrohet nëpërmjet votimit të hapur, i cili kryhet nëpërmjet sistemit të ngritjes së dorës.

## **20. PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

20.1 Anëtarët e shoqërisë mund përjashtohen nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së këtij anëtar;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja këtij anëtar.

## **21. PËRFAQËSIMI NË MBLEDHJE**

21.1 Një anëtar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një anëtar tjetër apo nga një person i tretë, në bazë të një prokure apo autorizimi të lëshuar nga anëtar, i cili përfaqësohet. Prokura apo autorizimi duhet të ketë përcaktuar shprehimisht që përfaqësuesi ka të drejtë të votojë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

21.2 Prokurat apo autorizimet përmenden në procesverbal dhe ruhen si pjesë e akteve të shoqërisë.

21.3 Prokura apo autorizimi nuk mund të lëshohet e paplotësuar, por duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për identifikimin e përfaqësuesit. Administratori nuk mund të veprojë si përfaqësues i anëtarëve në asamblenë e përgjithshme.

21.4 Prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

21.5 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë të tillë që, sipas gjykimit të anëtarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë, të ndryshëm nga ata të anëtarit të përfaqësuar.

## **22. KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE**

22.1 Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet sipas thirrjes, në zbatim të kërkesave të nenit 17.2 dhe nenit 18 të këtij Statuti.

22.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqësojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.

22.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut, Asambleja e Përgjithshme miraton vendimet e saj për çështjet e përcaktuara në nenin 16.2 të këtij statuti, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.

22.4 Pavarësisht sa është përcaktuar në pikat e mësipërme të këtij neni, kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet e mëposhtme: (i) miratimin e zvogëlimit apo zmadhimit të kapitalit; (ii) miratimin e ndryshimeve në statut; (iii) shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë; si dhe (iv) kur vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë; ajo mund të marrë vendime të vlefshme dhe miraton vendimet e saj, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.

22.5 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenet 22.2 dhe 22.4 të këtij statuti, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **23. PROCESVERBALI I MBLEDHJES**

23.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari.

23.2 Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të sekretarit, si dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e pjesëmarrësve, akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme, raportet dhe aktet e tjera të paraqitura në mbledhje si dhe prokurat apo autorizimet në rast se anëtarët përfaqësohen në mbledhje nga një anëtar tjetër apo nga një person i tretë.

23.3 Procesverballi dhe dokumentet e bashkëlidhura duhet të ruhen për një periudhë 5-vjeçare dhe anëtarët mund të kërkojnë kopje të tyre.

## KREU V ADMINISTRATORI

### 24. ADMINISTRATORI

24.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, të drejtat dhe detyrimet e të cilit janë të parashikuara në ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, në Statutin e shoqërisë si dhe në Aktin e Emërimit të tij.

24.2 Administrator i parë i Shoqërisë është: z. **Dritan Kamani**, lindur në Lushnjë, Shqipëri, më datë 05.09.1977, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 033083000, me numër personal H70905062J, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

24.3 Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar që nga data e themelimit/emërimit, me të drejtë rizgjedhjeje.

24.4 Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme sipas përcaktimit të nenit 22.3 të këtij Statuti.

24.5 Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.

24.6 Administratorit, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

### 25. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

25.1 Të gjitha vendimet e marra nga administratori do të quhen të vlefshme kur: janë nënshkruar nga ai dhe janë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

25.2 Administratori ka këto kompetenca:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë;
- c) thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e përcaktuara nga ky statut apo nga legjislacioni në fuqi.

- d) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- e) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
- f) krijon një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- g) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas ligjit;
- h) i raporton asamblesë së përgjithshme për zbatimin e orientimeve dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- i) kryerjen e çdo detyre tjetër të caktuara në ligj, statut, nga Asambleja e Përgjithshme si dhe nga Akti i Emërimit të tij.

25.3 Administratori mbikëqyr dhe siguron që zyrtarët, agjentët, të punësuarit, audituesit dhe këshilltarët e Shoqërisë, të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e shoqërisë.

## 26. DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

26.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj, në këtë Statut ose në Aktin e Emërimit të tij, në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë realizimit të suksesshëm të objektit të shoqërisë dhe ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita dhe duke konsideruar si të rëndësishëm interesin e shoqërisë dhe të anëtarëve të saj, si dhe të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- c) të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.



## KAPITULLI VI REGJIMI EKONOMIK

### 27. KAPITALI I REGJISTRUAR

27.1 Vlera e Kapitalit të regjistruar të shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë.

27.2 Kapitali ndahet në 9 kuota, nga të cilat: 1 kuotë e zotëruar nga FSHZH me 52% të kapitalit me vlerë 52,000 (pesëdhjetë e dy mijë) lekë; 4 kuota të bashkive, me vlerë 10,000 (dhjetë mijë) lekë secila dhe 4 kuota të tjera, me vlerë 2,000 (dy mijë) lekë secila, të renditura nga numri 1 deri në numrin 9, të nënshkruara nga anëtarët themelues sipas tabelës në pikën 27.4 më poshtë.

27.3 Kontributet në natyrë duhet të shprehen në vlerë ekonomike në bazë të një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert. Raporti i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet qendrës kombëtare të biznesit së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

27.4 Kapitali i regjistruar i shoqërisë zotërohet nga Anëtarët, si më poshtë vijon:

Anëtari	Kuota	Numërtimi	Përqindja e zotëruar në kapital	Vlera nominale
Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)	1	1	52%	52,000
Bashkia MAT	1	2	10%	10,000
Bashkia KLOS	1	3	10%	10,000
Bashkia BULOZË	1	4	10%	10,000
Bashkia DIBËR	1	5	10%	10,000
"Agjencia Ekonomike Mbështetëse" AEM sh.p.k.	1	6	2%	2,000
"Agjencia e Menaxhimit të Investimeve" AMI sh.p.k.	1	7	2%	2,000
"HUBEX-Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion"	1	8	2%	2,000
"AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje"	1	9	2%	2,000

### 28. NDRYSHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR

28.1 Kapitali mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të ligjit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor.

28.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e fitimit. Kontributet në natyrë duhet të shprehen në vlerë ekonomike, në bazë të një raporti vlerësimi, të bërë nga një ekspert. Nëse nuk mund të arrihet në mirëkuptim për vlerësimin, secili prej anëtarëve

mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me të dhënat e tjera, të kërkuara për regjistrimin e zmadhimit të kapitalit.

28.3 Zmadhimi i kapitalit kryhet nëpërmjet emetimit të kuotave të reja, apo nëpërmjet rritjes së vlerës së tyre. Kuotat do të jenë të nënshkruara dhe vlera e tyre do të jetë e shlyer plotësisht.

28.4 Ndryshimi i kapitalit nuk mund të arrijë deri aty sa të jetë më i vogël se kapitali minimal sipas nenit 27 të ligjit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor.

## **29. ANULIMI I KUOTAVE**

29.1 Shoqëria ka të drejtë të anulojë kuotat e kapitalit të saj dhe t'i likuidojë ato sipas vlerës së tyre kontabël.

29.2 Shoqëria mund t'i anulojë kuotat e saj, për shkak të:

- a) detyrimeve të anëtarëve ndaj palëve të treta;
- b) shkrirjen, likuidimin dhe/ose falimentimin e anëtarit;
- c) largimin vullnetar të anëtarit, në përputhje me nenin 13 të këtij Statuti;
- d) përjashtimin e anëtarit në përputhje me nenin 14 të këtij Statuti;
- e) zvogëlimin e kapitalit;
- f) transferimin e kuotave të parashikuar në nenin 30 të këtij Statuti.

## **30. TRANSFERIMI I PJESEVE TË KAPITALIT**

30.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të transferohen, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut, nëpërmjet:

- a) nënshkrimit të kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) dhurimit;
- d) në çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

30.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

## **31. FONDI I REZERVËS SË DETYRUESHME**

31.1 Shoqëria krijon fondin e rezervës së detyrueshme, i cili destinohet për konsolidimin dhe garancinë e kapitalit të shoqërisë e të aftësisë paguese të saj dhe është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.



31.2 Fondi i rezervës së detyrueshme krijohet nga derdhja në këtë fond e jo më pak se 15 për qind e fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura, në masën derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me kapitalin e shoqërisë, sipas nenit 27 të këtij statuti, apo çdo rritje të mëvonshme të tij.

### **32. FONDI I PËRBALLIMIT TË RISKUT**

32.1 Shoqëria krijon fondin e përballimit të riskut, që shërben për përballimin nga shoqëria të rreziqeve apo dëmeve të çfarëdolloj natyre, me të cilat mund të përballet veprimtaria e shoqërisë, përfshirë këtu edhe fenomenet natyrore apo ato dëme dhe risqe, të cilat janë të lidhura me vetë llojin e veprimtarisë ose të produktit.

32.2 Shoqëria depoziton në fondin e përballimit të riskut, 10 për qind të fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura. Ky fond është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.

### **33. DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI**

33.1 Shoqëria mban të dhënat e veprimtarisë së saj, në: (i) regjistrin e anëtarëve; (ii) regjistrin e vendimeve të organeve të saj; (iii) regjistrat për veprime financiare dhe kontabël. Mbjajtja e regjistrave të shoqërisë është nën përgjegjësinë e administratorit, sipas ligjit.

33.2 Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, në përputhje me ligjin nr. 25/2018, datë 10.5.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

33.3 Administratori përgatit raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël, të cilat i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

### **34. MBAJTJA E LLOGARIVE**

34.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë sipas kërkesave ligjore, sipas vitit fiskal, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atë kontabël në fuqi.

### **35. REZULTATI FINANCIAR DHE VENDIMMARRJA**

35.1 Fitimi i shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Pjesa e fitimeve të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë pas depozitimeve, në përputhje me nenet 31 dhe 32 të këtij Statuti, me vendim të asamblesë së përgjithshme mund të depozitohet e tëra ose pjesërisht në fondin e

përballimit të riskut ose mund t'u shpërndaheq anëtarëve apo të përdoret për fonde apo qëllime të tjera, sipas përcaktimeve të statutit dhe në përputhje me ligjet e zbatueshme.

35.2 Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Anëtarët sipas këtij neni, vetëm nëse paqë kësaj shpërndarje:

- a) asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

35.3 Në rastet kur veprimtaria e shoqërisë në fund të vitit financiar rezulton me humbje, asambleja e përgjithshme vendos nëse për mbulimin e humbjeve do të përdoret rezerva e detyrueshme apo ato do të mbarten për vitin pasardhës.

## KREU VII

### PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUIDIMI

#### 36. PRISHJA E SHOQËRISË

36.1 Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme (sipas nenit 45 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor):

- a) vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
- b) përmbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përmbushur atë;
- c) zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
- d) bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- e) reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmuajore;
- f) nisja e procedurave të falimentimit;
- g) mosushtrimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjohimi i pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- h) nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;

**BASHKIA DIBËR**

**Përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë**

**Rahim Spahiu**

**Agjencia Ekonomike Mbështesëse "AEM" sh.p.k.**

**Përfaqësuar nga Administratori**

**Alfred Dalipi**

**Agjencia e Menaxhimit të Investimeve "AMI" sh.p.k.**

**Përfaqësuar nga Administratori**

**Klodjan Bregu**

**HUBEX- Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion**

**Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv**

**Lediana Bardhi**

**AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje**

**Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv**

**Albano Idrizi**